

LIGJ
Nr. 68/2024

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 162/2014, "PËR MBROJTJEN E CILËSISË
SË AJRIT NË MJEDIS", I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 162/2014, "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", i ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Kudo në përmbajtje të ligjit akronimi "ISHMPU" zëvendësohet me fjalët "struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit".

Neni 2

Në neni 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 17 ndryshon si më poshtë:

"17. "Njësi të vetëqeverisjes vendore" ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit në fuqi për vetëqeverisjen vendore."

2. Pika 20 ndryshon si më poshtë:

"20. Struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit" është struktura e ngarkuar sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin dhe kontrollin e veprimtarive që lidhen me sektorin e mjedisit."

Neni 3

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 20

Kundërvajtjet

1. Çdo shkelje e kërkesave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, kur nuk përbën vepër penale, konsiderohet shkelje administrative dhe ndëshkohet me gjobë, pezullim apo mbyllje të veprimtarisë, përkatësisht:

a) mospërbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të shkarkimeve në ajër nga operatori i një instalimi, referuar lejes së mjedisit të tipave A apo B:

i. për lejet e mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë në vlerën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë;

ii. për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën 390 000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) deri në 650 000 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë;

b) ndotja e ajrit, e shkaktuar nga burimet e lëvizshme, në kundërshtim me kërkesat e nenit 13 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë;

c) prodhimi, importimi, tregtimi i lëndëve djegëse nga subjektet dhe përdorimi i lëndëve djegëse nga operatori, në kundërshtim me kërkesat e shkronjave "a" dhe "b" të nenit 14 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë)

lekë, në varësi të sasisë dhe rrezikshmërisë që paraqesin lëndët djegëse të palejuara, si dhe me sekuestrimin e lëndës djegëse që është gjendje;

c) mosrespektimi i masave për sigurimin e informacionit për konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO₂ gjatë marketingut të automjeteve të reja, sipas kërkesave të shkronjës “c” të nenit 14 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 200 000 (dyqind mijë) lekë;

d) mospërmbushja nga operatorët e kërkesave për pakësimin e rrjedhjeve dhe shkarkimeve të përbërësve organikë të avullueshëm (VOC), në kundërshtim me përcaktimet, sipas shkronjave “a”, “c” dhe “ç” të nenit 15 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) deri në 2 600 000 (dy milionë e gjashtëqind mijë) lekë, në varësi të sasisë e rrezikshmërisë që ato lëndë djegëse paraqesin, si dhe me pezullimin e veprimtarisë, për atë kohë sa të bëhet zëvendësimi i lëndës djegëse.

2. Kontrolli i zbatimit të këtij ligji dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe vendosja e gjobës dhe/apo pezullimi ose ndërprerja e veprimtarisë, sipas legjislacionit në fuqi për inspektimin, kryhet nga struktura përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, nga struktura inspektuese në ministrinë përgjegjëse për industrinë dhe nga struktura përgjegjëse inspektuese për mbikëqyrjen e tregut, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre.

3. Gjoha e dhënë në zbatim të këtij ligji përbën titull ekzekutiv pas shterimit të ankimit administrativ, sipas përcaktimeve në Kodin e Procedurave Administrative. Gjoha paguhet brenda 10 ditëve kalendarike nga data kur është njoftuar kundërvajtësi për vendimin e dënimit me gjobë që përbën titull ekzekutiv. Në rast mosekzekutimi vullnetar, për ekzekutimin e gjobës ngarkohet zyra e përmbarimit, sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurave Civile dhe në ligjin për kundërvajtjet administrative.”.

4. Në rastet kur shkeljet përbëjnë vepër penale, strukturat përgjegjëse për kontrollin dhe zbatimin e këtij ligji bëjnë kallëzim penal pranë organeve përkatëse.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.7.2024.

Shpallur me dekretin nr.252, datë 23.7.2024 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj